



TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH-së	NSH Cyclica Vushtrri/Vucitrn ("Ndërmarrja")
Emri i Ndërmarrjes së Re	Ndër. e Re Ngastra komerciale në Gracë SH.P.K.
Vendndodhja	Fshati Gracë; Komuna e Vushtrrisë
Biznesi/Spektori	Aktivitetet tregtare
Tregu:	Pronat e ndërmarrjes së Re gjenden në fshatin Gracë rreth 10 km në lindje të qytetit të Vushtrrisë. Në këtë ngastër komerciale më parë ka qenë një dyqan (emri i mëparshëm i dyqanit "29 Nëntori"1348/74) por që është rrënuar gjatë luftës. Për shkak të zhvillimit të sektorit privat ka një rritje të konsiderueshme të tregtisë me pakicë në Komunën e Vushtrrisë.
Punëtorët:	Asnjë punëtor i NSH-së nuk është caktuar në Ndërmarrjen e Re të tenderuar.
Ndërtesat dhe tokat	Ndër. e Re Ngastra komerciale në Gracë SH.P.K. përbëhet vetëm nga disa parcela. Ngastra komerciale (emri i mëparshëm i dyqanit "29 Nëntori"1348/74) e propozuar për bartje të Ndër. e Re gjendet në qendër të fshatit Gracë dhe përfshinë vetëm tokën në sipërfaqe prej rreth 1748 m ² sipas Fletës Poseduese nr. UL-70202022-00259, zona kadastrale Gracë, ngastrat kadastrale P-70202022-00410-0, P-70202022-00411-0, P-70202022-00412-0, dhe P-70202022-00413-0, regjistruar në emër të Ndërmarrjes. Gjatë vizitës sonë në teren është vërtetuar se parcela nuk është e shfrytëzuar ilegalisht.
Detyrimet që do të barten	Detyrimet që do të barten në Ndërmarrjen e Re janë këto që vijojnë më poshtë: (1) Detyrimet neto të NSh-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjocat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri; (2) Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri; (3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri; Nuk kemi hipotekë të regjistruar për pronën e Ndërmarrjes së Re cila e do të përfshihet në valën e 51 .



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Pamja e
Ndërmarrjes së Re**



Pamje nga ngastra komerciale

Informata

Departamenti për Shitje
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255
Faks: +381 (0) 38 500 400
www.pak-ks.org

**Dokumentet e
Ofertimit**

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Ilir Konushevci Nr:8
10000 Prishtinë, Kosovë